



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstoa za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV: nr. 25/2012 LICENCIMI I BARTËSVE PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË NË  
KOSOVË**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA : nr. 25/2012 LICENCIRANJE PRIVATNE NOSIOCE VISOKOG  
OBRAZOVANJA NA KOSOVU**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION: nr. 25/2012 LICENSING OF PRIVATE BEARERS OF HIGHER  
EDUCATION IN KOSOVA**

Në bazë të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82,21 tetor 2010), nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Licencimi i bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë**

NUMËR : 25/2012  
DATË: 22.10.2012

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrative është rregullimi normativ i themelimit, akreditimit, licencimit, dhe fushëveprimit të Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (në tekstin e mëtejme - BPrAL).

Na osnovu člana 4, 21 i 22 Zakona br. 03/Z-189 državnoj administraciji Republike Kosova, ( Službeni glasnik, br. 82, 21 oktobra 2010 ), kao i član 11 stav 3 Zakona o Viskom obrazovanju Republike Kosova i na osnovu člana 8 stav 1.4 i prilog 6 Pravilnika br. 02/2011 za oblast administrativne odgovornosti Kancelariji premijera i ministarstva (22. 03 2011), izdaje:

**ADMINISTRATIVNA UREDBA**

**Licenciranje privatne nosioce visokog obrazovanja na Kosovu**

**BROJ:  
DATUM:**

**Član 1  
Cilj**

1. Cilj ove Administrativne uredbe je regulisanje normativi osnivanja, akreditaciju, licenciranje i oblasti delovanja Privatne Nosioce Visokog Obrazovanja ( u daljem tekstu PNVO)

Pursuant to article 4, 21, 22 of the Law no. 03/L-189 for the state administration of the Republic of Kosova, (Official Gazette, nor. 82, 21 October 2010), articles 12, 14 and of the Law for Higher Education, being based in article 8 paragraph 1.4 and appendix 6 of the Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries (22.03.2011), issues this Administrative instruction:

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION:**

**Licensing of private bearers of higher education in Kosova**

**NUMBER:  
DATE:**

**Article 1.  
The purpose**

1. The purpose of this administrative instruction is normative adjustment of establishment, accreditation, licensing and scope of work of Private Bearers of Higher Education (in further text – PBHE).

<p>2. Ky Udhëzim administrativ përcakton kushtet dhe kriteret që BPrAL duhet t'i plotësojë për t'u licencuar nga MASHT-i, kompetencat e MASHT-it për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punës edukativo-arsimore dhe masat administrative që ai do t'i ndërmerr kundër BPrAL në rast të mosrespektimit të dispozitave që dalin nga ky Udhëzim, aktet tjera nënligjore në këtë fushë dhe nga Ligji mbi Arsimin e Lartë.</p>	<p>2. Ova Administrativan uredba određuje uslove i kriterijume koje PNVO treba da ispuni kako bi dobili licencu od strane MONT-a kompetencije MONT-a za nadgledanje održavanje edukativno-obrazovnog rada i administrativne mere koje će ono preduzeti protiv PNVO-a u slučaju nepoštovanje odredbi koje proizilaze iz ove uredbe, drugi podzakonskim aktima u ovoj oblasti i iz Zakona o Visokom obrazovanju.</p>	<p>2. This administrative instruction determines conditions and criteria that PBHE must meet to be licensed from MEST, competences of MEST for monitoring the performance of instructive-educational work and administrative measures that it will undertake against PBHE in case of violation of the provisions that come from this Instruction, other sub-legal acts in this field from the Law on Higher Education.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Themelimi i BPrAL</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Osnivanje PNVO-a</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 PBHE establishment</b></p>
<p>Themelimi i BPrAL bëhet në bazë të nenit 11 paragrafi 2 dhe neni 12 paragrafi 1 të Ligjit të Arsimin të Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037.</p>	<p>Osnivanje PNVO-a se vrši na osnovu člana 11 stav 2 i član 12 stav 1 Zakona o Visokom obrazovanju Republike Kosova br. 04/Z-037.</p>	<p>Establishment of PBHE is done based of article 11 paragraph 2 and article 12 paragraph 1 of the Law of Higher Education in the Republic of Kosova no. 04/L-037.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Fillimi i punës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Počinjanje sa radom</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Beginning of work</b></p>
<p>BPrAL nuk mund të fillojë punën pa u pajisur paraprakisht me licencë nga MASHT-i.</p>	<p>PNVO ne može da počne sa radom pre nego što dobije licencu iz MONT.</p>	<p>PBHE cannot start the work without being equipped priory with licence from MEST.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Fushëveprimtaria, funksioni i BPrAL</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Oblast delovanja, funkcionisanje</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Activity field, the function of PBHE</b></p>

<p>1. Veprimtaria e BPrAL është :</p> <p>1.1. Krijimi, zhvillimi, nxitja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore;</p> <p>1.2. Ofrimi i mundësive për të gjithë të interesuarit për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës;</p> <p>1.3. Zgjerimi i kapaciteteve të arsimit të lartë;</p> <p>1.4. Zhvillimi dhe modernizimi i sistemit të arsimit të lartë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Kërkesa për licencë</b></p> <p>Çdo BPrAL, pasi të jetë akredituar nga AKA mund të licencohet nga MASHT.</p>	<p style="text-align: center;"><b>PNVO-a</b></p> <p>1. Oblast delovanja PNVO-a je</p> <p>1.1. Stvaranje, razvoj podsticanje i prenos znanja pomoću nastave i naučno – istraživačkih radova,</p> <p>1.2. Pružanje mogućnosti za sve zainteresovane za korist koju [e imati iz celoživotnog obrazovanja;</p> <p>1.3. Povećanje kapaciteta visokog obrazovanja,</p> <p>1.4. Razvoj i modernizacija sistema visokog obrazovanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Zahtev za licenciranje</b></p> <p>Svaka PNVO, nakon što bude akreditovana od strane KAA može biti licencirana od strane MONT-a</p>	<p>1. The activity of PBHE is:</p> <p>1.1. Creation, development, stimulation and transmission of knowledge through teaching and scientific-research work;</p> <p>1.2. Provision of opportunities for all interested to benefit from this education during whole life;</p> <p>1.3. Expansion of higher education capacities;</p> <p>1.4. Development and modernization of higher education system.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Request for licence</b></p> <p>Each PBHE, after being accredited from KAA can be licensed from MEST.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Licencimi</b></p> <p>1. MASHT licencon BPrAL të cilët ofrojnë programet e akredituara nga agjencitë e njohura akredituese, anëtare të organizmave ndërkombëtare të akreditimit, pasi programi i tyre të aprovohet nga AKA.</p> <p>2. Afati i licencës mund të zgjasë varësisht</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Licenciranje</b></p> <p>1. MONT licencira PNVO koji nude akreditovane programe od strane poznatih agencija za akreditaciju, članicu međunarodnog akreditovanog tela, nakon što njihov program bude odobren od strane KAA.</p> <p>2. Rok licence može da traje u zavisnosti</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Licensing</b></p> <p>1. MEST licenses PBHE which provide accredited programs from accrediting agencies, members of known international bodies of accreditation, after their program to be valid from KAA.</p> <p>2. Licensing deadline could last depending</p>

<p>nga kohëzgjatja e akreditimit nga AKA, por jo më gjatë se 5 vite.</p> <p><b>3.</b> BPrAL duhet të kërkoj plotësim licence në raste të akreditimit të programeve të reja apo hapjes së një njësie akademike në një qendër tjetër.</p>	<p>od trajanja akreditacije koju će dobiti od strane KAA, ali ne više od 5 godine.</p> <p><b>3.</b> PNVO treba da zahteva dopunu licence u slučaju akreditacije novih programa ili otvaranje akademske jedinice u nekom dugom centru.</p>	<p>from time duration of accreditation from KAA, but not more than 5 years.</p> <p><b>3.</b> PBHE may seek license supplementation in cases of new program accreditation or opening of an academic unit in another centre.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Kushtet dhe kriteret</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Uslovi i kriterijumi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Conditions and criteria</b></p>
<p><b>1.</b> BPrAL mund të licencohet nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin e AL dhe aktet nënligjore të nxjerra nga MASHT.</p> <p><b>2.</b> Kushtet e përgjithshme :</p> <p><b>2.1.</b> Kërkesa për licencim e BPrAL;</p> <p><b>2.2.</b> Vendimi për themelimin e BPrAL;</p> <p><b>2.3.</b> Emërtimi dhe selia e BPrAL;</p> <p><b>2.4.</b> Struktura organizative e BPrAL (organogrami);</p> <p><b>2.5.</b> Historiku i shkurtër i BPrAL (vetëm për ato që kanë punuar edhe më parë);</p> <p><b>2.6.</b> Certifikata e regjistrimit nga organi kompetent;</p> <p><b>2.7.</b> Dëshmia për pronësinë ose për marrjen me qira të lokaleve se paku për kohën e kërkuar për licencë</p> <p><b>2.8.</b> Vërtetimi mbi plotësimin e kushteve higjieniko-sanitare;</p> <p><b>2.9.</b> Vërtetimi mbi plotësimin e kushteve për siguri nga zjarri;</p>	<p><b>1.</b> PNVO može dobiti licencu u koliko ispunjava uslove i kriterijume određene Zakonom o VO i druge podzakonske akte izdate od strane MONT-a.</p> <p><b>2.</b> Opšti uslovi:</p> <p><b>2.1.</b> Zahtev za licenciranje PNVO-a</p> <p><b>2.2.</b> Odluka za osnivanje PNVO-a;</p> <p><b>2.3.</b> Naziv i sedište PNVO-a;</p> <p><b>2.4.</b> Organizaciona struktura PNVO-a (organogram);</p> <p><b>2.5.</b> Kratak istorijat PNVO-a ( samo za one koji su radili i ranije) ;</p> <p><b>2.6.</b> Certifikat o registraciji kompetentnog organa;</p> <p><b>2.7.</b> Dokaz vlasništva ili korišćenje pod kiriju lokale za vreme najmanje za koliko se traži licenca</p> <p><b>2.8.</b> Potvrda o ispunjavanju higijensko-sanitarnih uslova;</p> <p><b>2.9.</b> Potvrda o ispunjavanju bezbednosnih uslova od požar;</p>	<p><b>1.</b> PBHE may be licensed if it meets conditions and set criteria with Law of HE and sub-legal acts issued from MEST.</p> <p><b>2.</b> General conditions:</p> <p><b>2.1</b> Request for licensing of PBHE;</p> <p><b>2.2</b> Decision for establishment of PBHE;</p> <p><b>2.3</b> Denomination and location of PBHE;</p> <p><b>2.4</b> Organizational structure of PBHE (organizational chart);</p> <p><b>2.5</b> Short history of PBHE (only for those that have worked before);</p> <p><b>2.6</b> Certificate of registration from the competent body;</p> <p><b>2.7</b> Proof of ownership or for rental of premises at least for the time required for licence;</p> <p><b>2.8</b> Certification on meeting hygiene-sanitation conditions;</p> <p><b>2.9</b> Certification on meeting conditions</p>

<p>2.10. Statuti për qeverisje;  2.11. Rregullorja e punës;  2.12. Kodi i mirësjelljes i BPrAL;  2.13. Vërtetimi nga organet e juridiksionit se kundër themeluesit të BPrAL nuk është hapur ndonjë procedurë ligjore;  2.14. Lokale të mjaftueshme dhe të pajisura sipas standardeve të përcaktuara nga MASHT-i;</p> <p>2.15. Objektet në të cilat zhvillohet veprimtaria arsimore, kërkimore-shkencore duhet të jenë të pajisura me leje ndërtimi nga organi kompetent dhe të dedikuara për këtë veprimtari;</p> <p>2.16. Bibliotekën me inventar dhe me fond të pasur librash nga fusha përkatëse;  2.17. Kabinetet me pajisje kompjuterike dhe me pajisje përkatëse për fushat e caktuara;  2.18. Lista e punëtorëve mësimorë, kërkimor-shkencorë, me gradat dhe thirrjet akademike dhe kualifikime përkatëse të fushës së ngushtë (kopjet e vërtetuara të diplomave ose të certifikatave, për diplomat e marra jashtë kopja e diplomës së barasvlerësuar / njohur, );  2.19. Lista e kuadrit administrativ dhe</p>	<p>2.10. Statut o upravljanju;  2.11. Pravilnik rada;  2.12. Kodeks dobrog ponašanja PNVO  2.13. Potvrda pravosudnog organ da protiv osnivača PNVO-a nije podignuta nikakva zakonska procedura;</p> <p>2.14. Dovoljnu lokaciju i opremljenu prema standardima određenim od strane MONT-a;</p> <p>2.15. Objekti u kojima se odvija obrazovna, naučno – istraživačka delatnost treba da imaju dozvolu od strane kompetentnih organa za njihovu gradnju koja je namenjena za ovu delatnost;</p> <p>2.16. Biblioteko sa inventarom obogaćenom dotičnom literaturom;  2.17. Kabinet sa kompjuterima i dotičnom opremom za određenu oblast;</p> <p>2.18. Spisak nastavnog osoblja, naučno-istraživaće, sa akademskim zvanjem i stepenom i dotičnim kvalifikacijama uže delatnosti ( overene kopije diplome ili certifikata, za diplome stečene u inostranstvu kopija diplome izvršene ekvivalentnost / priznanje);  2.19. Spisak administrativnog i</p>	<p>for safety from fire;  2.10 The governing statute;  2.11 Rules of Procedure;  2.12 Code of good conduct of PBHE;  2.13 Certification from organs of jurisdiction that against founder of PBHE is not opened any legal procedure;  2.14 Sufficient premises and equipped according to set standards from MEST</p> <p>2.15 Facilities in which is developed scientific-educational activity should be equipped with construction permission from the competent body and dedicated for this activity;</p> <p>2.16 Library with inventory and rich book fund from the relevant field;  2.17 Cabinets with computer equipments and with relevant equipment for certain fields;  2.18 The list of teaching/scientific employees, with grades and academic calls and relevant qualifications of the close subject (verified photocopies of diplomas or of certificates, for diplomas taken abroad, copy of the diploma that is equivalent / recognized);  2.19 The list of administrative and</p>
--	---	---

<p>ndihmës; shkalla e kualifikimit të tij/saj (fotokopjet e vërtetuara të diplomave / certifikatave);</p> <p><b>2.20.</b> Plani dhe programi vjetor i punës së BPrAL;</p> <p><b>2.21.</b> Emërtimi i dokumenteve që BPrAL do t' u lëshojë studentëve (modelet);</p> <p><b>2.22.</b> Kopja e kontratës ndërmjet BPrAL dhe personelit (modeli);</p> <p><b>2.23.</b> Garancion bankar për shumën e të hyrave nga studentët për vitin akademik i cili garanton përfundimin e programit si dhe në rast të mosakreditimit të programit apo mbylljes së BprAL për transferin e studentëve në BprAL tjetër në bazë të marrëveshjes së lidhur mes BprAL nën mbikëqyrjen e AKA.</p> <p><b>2.24.</b> Plani i biznesit i BPrAL për kohëzgjatjen e kërkesës për licencim, së paku për tri vite;</p> <p><b>2.25.</b> Shuma e caktuar e pagesës që studenti është i obliguar të paguaj për një vit akademik.</p> <p><b>3.</b> Kushtet dhe kriteret për themelimin e institucioneve të ndryshme në arsimin e lartë rregullohen në bazë të Ligjit të AL dhe udhëzimeve përkatëse administrative.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Dokumentacioni i pakompletuar</b></p>	<p>pomoćnog osoblja; nivo njihove /njene kvalifikacije ( overene fotokopije diploma/certifikata);</p> <p><b>2.20.</b> Godišnji plan i program rada PNVO-a;</p> <p><b>2.21.</b> Naziv dokumenta koje će PNVO izdavati studentima (modeli);</p> <p><b>2.22.</b> Kopija ugovora između PNVO-a i osoblja (model);</p> <p><b>2.23.</b> Bankarska garant za iznos prihoda od strane studenata za akademsku godinu koji garantira završenje programa kao i u slučaju nezavršavanja programa ili zatvaranja PNVO za transfer studenata u drugi PNVO na osnovu povezanog sporazuma među PNVO pod nadzorom KAA.</p> <p><b>2.24.</b> Biznis plan PNVO za vremenski period trajanja licence, najmanje tri godine;</p> <p><b>2.25.</b> Određeni iznos uplate za koju je student dužan da plati jednu akademsku godinu.</p> <p><b>3.</b> Uslovi i kriterijumi za osnivanje različite visoko obrazovne institucije regulišu se na osnovu Zakona o VO i dotične administrativne uredbe.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Ne kompletirana dokumentacija</b></p>	<p>assisting personnel, scale of his/her qualification (verified photocopies of diplomas or of certificates);</p> <p><b>2.20</b> Annual work plan and program of PBHE;</p> <p><b>2.21</b> Denomination of documents that PBHE will issue to students (models);</p> <p><b>2.22</b> Copy of the contract between PBHE and personnel (model);</p> <p><b>2.23</b> Bank guarantee for the amount of incomes from students for the academic year, which guarantees completion of program and in case of programme non-accreditation or closure of PBHE for students' transfer in the other PBHE according to the agreement between PBHE under supervision of KAA ;</p> <p><b>2.24</b> Business plan of PBHE for duration of request for licensing at least for three years;</p> <p><b>2.25</b> Certain amount of payment that student is obliged to pay for one academic year.</p> <p><b>3.</b> Conditions and criteria for establishment of different institutions in higher education are regulated according to the Law of HE and relevant administrative instructions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Uncompleted documentation</b></p>
---	---	---

<p>Dokumentet e pakompletuara për aplikim nuk do të merren në shqyrtim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9 Ndryshimet</b></p>	<p>Dokumentacija za aplikaciju koja nije kompletirana neće biti uzeta na razmatranje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9 Razlika</b></p>	<p>Uncompleted documents for application will not be taken into consideration.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9 Changes</b></p>
<p>1. MASHT-i rezervon të drejtën që, në përputhje me Ligjin e AL dhe me ndryshimet që mund të bëhen në sistemin e arsimit, të ndryshojë kushtet dhe kriteret ekzistuese apo të caktojë kushte dhe kriteret të reja për licencimin e BPrAL.</p> <p>2. Këto ndryshime mund të bëhen edhe gjatë vitit akademik, por ato do të zbatohen vetëm në fillim të vitit të ri akademik.</p> <p>3. MASHT do të njoftojë BPrAL se paku 3 muaj me heret për ndryshimet që do të pasojnë në vitin akademik vijues.</p>	<p>1. MONT zadržava pravo da, u skladu sa zakonom o VO i promenama koje mogu nastupiti u obrazovnom sistemu, da promeni postojeće uslove i kriterijume ili da odredi nove kriterijume za licenciranje PNVO-a .</p> <p>2. Ove promene mogu nastupiti i u toku akademske godine, ali one će oni moći da se primene na početak nove školske godine.</p> <p>3. MONT će saopštiti PNVO najmanje tri meseca ranije u vezi promene koje će nastupiti u toku naredne akademske godine.</p>	<p>1. MEST reserves the right that in accordance with Law and with amendments that will be done in education system, to change existing conditions and criteria or to set new conditions and criteria for licensing of PBHE.</p> <p>2. These changes could be done also during academic year, but those will be applied only in the beginning of the new academic year.</p> <p>3. MEST will notify in time PBHE for changes that will come in the following academic year.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10 Procedura e licencimit</b></p> <p>1. MASHT do të formojë një Komision të veçantë i cili do të shqyrtojë kërkesat për licencimin e BPrAL.</p> <p>2. MASHT do të licencojë secilin BPrAL që ka plotësuar kushtet dhe kriteret e vëna me LAL dhe këtë UA.</p> <p>3. Komisioni për licencim në MASHT do të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10 Procedura za licenciranje</b></p> <p>1. MONT će formirati posebnu komisiju koja će razmatrati zahteve za licenciranje PNVO-a.</p> <p>2. MONT će licencirati sve pojedinačno PNVO koji ispune uslove i kriterijume uspostavljene ZVO i ove AU.</p> <p>3. Komisija za licenciranje u MONT će</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10 Licensing procedure</b></p> <p>1. MEST will form a special Commission, which will review requests for licensing of PBHE.</p> <p>2. MEST will license each PBHE that has met placed conditions and criteria with LHE and this AI.</p> <p>3. Commission licensing in MEST will</p>



<p>merr Vendim për dhënien apo mosdhënien e licencës, më së voni, 12 muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës për licencim në MASHT.</p>	<p>doneti odluku o dodeli ili ne dodeljivanju licence, najkasnije 12 meseci od dana podnošenje zahteva za licenciranje u MONT.</p>	<p>take Decision for granting or non-granting of the licence, at the latest, 12 month from the day of request submission for licensing in MEST.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11 Ankesa</b></p> <p>1. Në rast të refuzimit të kërkesës për dhënien e licencës, pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për refuzimin e dhënies së licencës.</p> <p>2. Ankesat e paraqitura ndaj vendimit të kryetarit të Komisionit për licencim, i shqyrton Sekretari i përgjithshëm i MASHT-it.</p> <p>3. Vendimi i nxjerrë nga MASHT-i, pas rishqyrtimit të ankesës, do të ketë karakterin e aktit administrativ përfundimtar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11 Žalba</b></p> <p>1. U slučaju odbijanje zahteva za dodelu licence, nezadovoljna strana ima pravo da podnese žalbu u roku od 15 dana od dana uručivanje rešenja o odbijanju dodele licence.</p> <p>2. Predstavljene žalbe na odluku predsednika Komisije za licenciranje razmatra ih Generalni sekretar u MONT.</p> <p>3. Odluka koju će doneti MONT-a nakon razmatranja žalbe, će biti završnog administrativnog karaktera.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11 Appeal</b></p> <p>1. In case of request denial for granting of the license, unsatisfied party has the right to appeal in term of 15 days from the day of decision acceptance for denial of granting the licence.</p> <p>2. The submitted appeals toward decision of the chairman of Commission for licensing, reviews the General Secretary of MEST.</p> <p>3. The issued decision from MEST, after review of the appeal, will have the character of the final administrative act.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12 Krijimi dhe mbajtja e të dhënave</b></p> <p>1. MASHT do të hartojë, për çdo vit, një regjistër në të cilin do të mbahen të dhënat e nevojshme për BPrAL të licencuara dhe të dhënat tjera të nevojshme të procedurës së licencimit.</p> <p>2. Me përjashtim të shënimeve financiare, të dhënat tjera të paraqitura në regjistër, mbi</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12 Formiranje i održavanje podataka</b></p> <p>1. MONT će sastaviti, za svaku godinu, spisak u kojemu će biti evidentirati potrebni podaci za licenciranje PNVO i druge potrebne podatke procedure za licenciranje.</p> <p>2. Uz izuzetak finansijske evidencije, ostali podaci prikazani u registar, na osnovu</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12 Establishment and data maintenance</b></p> <p>1. MEST will compile, for each year a register in which will be kept necessary data's for licensed PBHE and other necessary data of the licensing procedure.</p> <p>2. With exception of financial notes, other presents data in the register, over the basis</p>

bazë të kërkesës së parashtruar, do të jenë të hapura për publikun (web-faqe të MASHT).

### **Neni 13 Ripërtëritja e licencës**

1. Licenca e BPrAL duhet të (ri)përritret varësisht prej kërksave për ndryshime dhe kohëzgjatjes së licencës.
2. Në rast të ndryshimit të kushteve të punës në BPrAL, ai duhet t'i bëjë Kërkesë MASHT-it për ndryshimin e kushteve të licencës.
3. Për (ri)përritritjen e licencës BPrAL duhet:
  - 3.1. Të paraqesë dokumentacionin e kompletuar, sipas kushteve dhe kriterëve të parapara me LAL dhe të këtij Udhëzimi
  - 3.2. Të paraqesë kërkesë për (ri)përtëritjen e licencës në të cilën përfshihet puna e BPrAL gjatë vitit akademik paraprak.
4. MASHT-i vërteton saktësinë e të dhënave që përmban dokumentacioni i paraqitur; kërkon paraqitjen e dokumentacionit shtesë atëherë kur konsideron se dokumentacioni i paraqitur është i pamjaftueshëm për të marrë vendim meritore lidhur me kërkesën e BPrAL për licencim.

### **Neni 14 Refuzimi apo mospërtëritja e licencës**

podnesenog zahteva, će biće otvoreni za javnost ( web-stranici MONT-a ).

### **Član 13 Obnova licence**

1. Licenciranje PNVO treba biti obnovljeno u zavisnosti od zahteva za promenu i vremensko trajanje licence.
2. U slučaju promene uslova rada u PNVO, treba podneti zahtev MONT-u za promenu uslova za licenciranje.
3. Za obnovu licence PNVO treba:
  - 3.1. Da podnese kompletnu dokumentaciju, prema uslovima i kriterijima predviđenim ZVO i ove Uredbe.
  - 3.2. Da podnese zahtev za obnovu licence u koju je obuhvaćen rad PNVO u tokom prethodne akademske godine.
4. MONT overava verodostojnost podataka koje sadrži predstavljena dodatna dokumentacija; traži dostavljanje dodatne dokumentacije kad smatra da je dostavljena dokumentacija nedovoljna za dobijanje meritornog rešenja u vezi PNVO za licenciranje.

### **Član 14 Odbijanje ili ne obnavljanje licence**

of the submitted request, will be opened for publication.

### **Article 13 License renewal**

1. License of PBHE must be renewed depending from request for changes and time duration of the license.
2. In case of change of working conditions in PBHE, he should make request to MEST for changing of license conditions.
3. For renewal of license PBHE should:
  - 3.1. To present completed documentation, according to the foreseen conditions and criteria with LHE and of this Instruction;
  - 3.2. To present request for renewal of license in which is included the work of PBHE during prior academic year.
4. MEST has the right to confirm the data accuracy that contains the presented documentation, to require presentation of additional documentation then when considers that the presented documentation is insufficient to take a meritorious decision regarding the request of PBHE for licensing.


### **Article 14 Non-issuance or non-repetition of the**

<p>1. MASHT nuk do t'i jep licencë BPrAL në rast se:</p> <p>1.1. Nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me LAL dhe me këtë Udhëzim;</p> <p>1.2. Nëse ka ofruar të dhëna jo të sakta.</p>	<p>1. MONT neće dodeliti licencu PNVO u slučaju da:</p> <p>1.1 Ne ispunjavanje uslova predviđenih ZVO i ovom Uredbom;</p> <p>1.2. U slučaju da je dostavio pogrešne podatke</p>	<p style="text-align: center;"><b>license</b></p> <p>1. MEST will not give license to PBHE in case if:</p> <p>1.1. Did not met foreseen conditions with LHE and with this Instruction;</p> <p>1.2. If has provided incorrect data.</p>
<p><b>Neni 15</b> <b>Revokimi i licencës</b></p>	<p><b>Član 15</b> <b>Oduzimanje licence</b></p>	<p><b>Article 15</b> <b>Licence revocation</b></p>
<p>1. MASHT mban të drejtën që t'ia revokoj licencën BPrAL:</p> <p>1.1. Në rast të revokimit të akreditimit nga ana e AKA;</p> <p>1.2. Nëse BPrAL ka ndryshuar kushtet e parapara me licencë;</p> <p>1.3. Nëse BPrAL paraqet rrezik serioz për shëndetin apo për jetën e studentëve ose për personelin e tij;</p> <p>1.4. Nëse BPrAL është shërbyer me mashtrime, keqpërfaqësime ose keqpërdorime me rastin e marrjes së licencës nga MASHT;</p> <p>1.5. Nëse BPrAL ka një akt administrativ përfundimtar apo vendim gjyqësor të formës së prerë i cili vërteton se ka shkelje serioze të dispozitave ligjore nga ana e tij dhe</p> <p>1.6. Nëse te BPrAL konstatohen parregullsi serioze në mbarëvajtjen e</p>	<p>1. MONT zadržava pravo da oduzme licencu PNVO-u;</p> <p>1.1. U slučaju oduzimanje akreditacije od strane KAA;</p> <p>1.2. Ako je PNVO promenio uslove predviđene licencom;</p> <p>1.3. Ako PNVO predstavlja ozbiljnu opasnost za zdravlje i život studenta ili za njegovo osoblje;</p> <p>1.4. Ako se PNVO koristio prevarom, lošeg predstavljanja ili zloupotrebe prilikom dobijanja licence od strane MONT-a;</p> <p>1.5. Ako PNVO ima završni administrativni akt ili konačnu sudsku odluku koja potvrđuje da je bilo ozbiljnog kršenja zakonskih odredbi s njegove strane i</p> <p>1.6. Ako se dokažu ne pravilnosti u PNVO tokom održavanje nastavnog</p>	<p>1. MEST keeps the right to take the license from PBHE:</p> <p>1.1. In case of accreditation revocation by the side of KAA.</p> <p>1.2. If PBHE had changed foreseen conditions with licence;</p> <p>1.3. In case if he represents serious danger for health or for students life or for its personnel;</p> <p>1.4. In case if he is served with fraud, bad representations or misuse upon receipt of the license from MEST;</p> <p>1.5. If PBHE has a final administrative act or court decision of the final form, which proves that there are serious violations of legal provisions by his side and;</p> <p>1.6. If at PBHE is ascertain serious irregularities in the progress of the</p>

<p>procesit arsimor të cilat nuk janë mënjeluar edhe pas vërejtjes së MASHT-it.</p> <p>2. Në rast të revokimit të licencës, BPrAL iu përgjigjet financiarisht të dëmtuarve (studentëve dhe personelit) për pasojat e shkaktuara nga akti i tillë.</p>	<p>procesa i koje nisu eliminisane nakon opomene MONT-a.</p> <p>2. U slučaju oduzimanje licence PNVO finansijski je odgovoran oštećenima ( Studentima i osoblju ) za posledice izazvane takvim činom.</p>	<p>educational process which are not removed even after the MEST notice.</p> <p>2. In case of licence removal from MEST, PBHE will respond financially to the damaged (students and personnel) for caused consequences from such act.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Të dhënat financiare</b></p> <p>1. Të dhënat financiare të ofruara nga BPrAL nuk do të bëhen publike dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera, përveç në rast të kryerjes së hetimeve në kontestin administrativ, civil ose penal.</p> <p>2. Për publikimin e paautorizuar të shënimeve financiare, MASHT-i mund të merr masa disiplinore ndaj personit përgjegjës për mosruajtjen e fshehtësisë afariste.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Finansijski podaci</b></p> <p>1. Finansijski podaci koji su dostavljeni od strane PNVO neće biti objavljeni i neće biti korišćeni za druge svrhe, osim u slučaju istrage u administrativnim, civilnim ili krivičnim sporovima.</p> <p>2. Za neovlašćeno objavljivanje finansijskih podataka, MONT može da preduzme disciplinske mere prema odgovornom licu zbog ne čuvanje poslovne tajne.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>The financial data</b></p> <p>1. The financial data provided from PBHE will not become public and will not be used for other purposes, except in the case of conducting investigations in the administrative context, civil or penal.</p> <p>2. For unauthorized publication of financial records, MEST could take disciplinary measures toward responsible person for not keeping of commercial confidentiality</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Ruajtja e dokumentacionit</b></p> <p>1. Secili BPrAL duhet të mbajë dosjet e përhershme të studentëve dhe të personelit të vet.</p> <p>2. MASHT-i mund të kërkojë nga BPrAL që të përgatisë një Plan të pranueshëm për</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Čuvanje dokumentacije</b></p> <p>1. Svaki PNVO treba da ima stalni dosije studenta i svog osoblja .</p> <p>2. MONT može da zatraži od PNVO da pripreme prihvatljivi plan za MONT u cilju očuvanje takvog dosijea, u skladu sa</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Saving of documentation</b></p> <p>1. Every PBHE should keep permanent files of students and of its personnel.</p> <p>2. MEST could require from PBHE to prepare an acceptable plan for MEST for preservation of such files, in accordance</p>

<p>MASHT- in për ruajtjen e dosjeve të tilla, në përputhje me ligjin mbi arkivin.</p> <p>3. MASHT-i mund të kërkojë që plani i tillë të përfshijë arkivimin e dokumentacionit të dorëzuar me qëllim të ruajtjes së dosjeve nëse BPrAL pushon së vepruari.</p>	<p>zakonom o arhivi.</p> <p>3. MONT može da zatraži takav plan da obuhvati arhiviranje dostavljene dokumentacije u cilju čuvanja dosijea u slučaju da PNVO prestane sa radom.</p>	<p>with the law on archive.</p> <p>3. MEST could require that such plan to include archiving of submitted documents in order of file preservation if PBHE ceases to act.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Parregullsitë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Nepravilnosti</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Irregularities</b></p>
<p>MASHT-i nuk do t'ia jep apo ripërtërië licencën BPrAL nëse konstatohet se dokumentacioni i paraqitur për këtë qëllim përmban të dhëna të pasakta.</p>	<p>MONT neće dati ili obnoviti licencu PNVO-u u koliko bude dokazano da u dostavljenoj dokumentacija dostavljena za ovoj cilj sadrži netačne podatke.</p>	<p>MEST will not give or renew licence to PBHE if it is ascertain that the presented documentation for this purpose contains incorrect data.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Mbyllja e BPrAL</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Zatvaranje PNVO</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Closing of PBHE</b></p>
<p>1. Një BPrAL do të pushojë së funksionuari:</p> <p>1.1. Me iniciativën e themeluesit të BPrAL;</p> <p>1.2. Me revokimin e akreditimit nga AKA</p> <p>1.3. Në rast të ndryshimit të kushteve të licencës së dhënë nga MASHT.</p> <p>2. Themeluesi ka të drejtë të iniciojë mbylljen e BPrAL në çdo kohë, por mund ta mbyllë atë vetëm në fund të vitit akademik. Në rast të kundërt, MASHT-i shfrytëzon</p>	<p>1. PNVO će prestati sa funkcionisnjem:</p> <p>1.1. Na inicijativu osnivača PNVO-a</p> <p>1.2. U slučaju oduzimanje akreditaciju od strane KAA.</p> <p>1.3. U slučaju promene uslova za licenciranje određenih od strane MONT-a.</p> <p>2. Osnivač ima pravo da inicira zatvaranje PNVO-a u svako doba, ali može da to može učiniti samo na kraju akademske godine. U suprotnom, MONT će koristiti sredstva iz garantnog fonda, u dovoljnoj</p>	<p>1. A PBHE will cease functioning:</p> <p>1.1. With the initiate of PBHE establishment;</p> <p>1.2. With revocation of accreditation by KAA;</p> <p>1.3. In case of changing the licence conditions given by MEST.</p> <p>2. The founder has the right to initiate closing of PBHEs at any time, but could close it only at the end of academic year. Otherwise, MEST uses means of a guarantee fund, in the necessary degree, to</p>

<p>mjetet nga fondi garantues, në shkallën e nevojshme, për të mbrojtur interesat financiare të studentëve të cilët mund t'i vazhdojnë studimet në ndonjë institucion tjetër me program të njëjtë ose të përafërt të studimeve.</p>	<p>meri kako bi bili zaštićeni finansijski interesi studenata koji mogu nastaviti studije u nekoj drugoj instituciji istim ili sličnim programom studije.</p>	<p>protect students' financial interests which could continue studies in same or approximate program of studies.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Taksat për licencim</b></p> <p>MASHT-i cakton një shumë të arsyeshme të taksave për licencim i cili rregullohet me një vendim nga ana e Ministrit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Takse za licenciranje</b></p> <p>MONT određuje razumnu taksu za licenciranje koja se reguliše odlukom od strane Ministra</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Licensing fees</b></p> <p>MEST sets a very reasonable amount of licensing fees which is adjusted with decision by the side of the Minister.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Mbikëqyrja e BPrAL</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. MASHT-i mund ta vizitojë BPrAL në çdo kohë, pa paralajmërim, me qëllim të ushtrimit të kontrollit në të.</li> <li>2. Udhëheqja e BPrAL ka për detyrë të krijojë kushte të favorshme për punën e zyrtareve të MASHT-it dhe t'iu ofrojë atyre bashkëpunim të plotë gjatë kohës së kryerjes së kontrollit.</li> <li>3. MASHT-i do të njoftojë me shkrim BPrAL për gjendjen e konstatuar në të, gjatë ushtrimit të kontrollit dhe sipas nevojës dhe rastit, atij do t'i bëjë sugjerime dhe rekomandime të caktuara, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së konstatuar, duke i caktuar edhe afatin kohor për përmirësim.</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Nadzor PNVO-a</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. MONT ima pravo posete PNVO-a u svako doba, bez najavlivanja, u cilju izvršavanje njegovih kontrole.</li> <li>2. Rukovodioci PNVO-a imaju zadatak da obezbede potrebne uslove za rad službenike iz MONT i da omoguće njima potpunu saradnju za vreme vršenje kontrole.</li> <li>3. MONT će pismenim putem da saopšti PNVO-u u vezi konstatovano stanje u njemu, tokom kontrolisanje i prema potrebi i slučaju, njemu će dati sugestije i određene preporuke, u cilju poboljšanja konstatovanog stanja, određujući i vremenski period za poboljšanje.</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Supervision of PBHE</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. MEST could visit PBHE at any time, without warning, in order to put control over it.</li> <li>2. PBHE leadership has for assignment to create favourable conditions for the work of MEST officials, and to provide them full cooperation during the time of control performance.</li> <li>3. MEST will notify on writing PBHE for the ascertain condition in it, during control exercise and according to the need and the occasion, it will make suggestions to it and certain recommendation, in order to improve the ascertain condition, by setting also deadline for improvement.</li> </ol>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 22 Zbatimi</b></p> <p>Në rast të ndonjë zbrazëtie juridike në këtë udhëzim, drejtpërsëdrejti do të zbatohet Ligji mbi arsimin e lartë dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22 Primena</b></p> <p>U slučaju nekih pravih nedostataka u ovoj uredbi, direktno će biti primenjen Zakon o visokom obrazovanju i drugi podzakonski akti koji su na snazi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22 Implementation</b></p> <p>In case of any legal gap in this instruction, directly will be implemented the Law on Higher Education and other sub-legal acts in force.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23 Dispozitat shfuqizuese</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij UA shfuqizohet UA nr.14 /2003 dt. 17.07.2003.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23 Van snažne odredbe</b></p> <p>Stupanjem na snagu ove AU stavlja van snage AU br. 14/2003 datuma 17.07.2003.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23 Repealing provisions</b></p> <p>With entry into force of this AI is repealed AI no. 14/2003 dt. 17.07.2003.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 24 Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;"> <b>Prof. dr. Ramë Buja, ministër</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24 Stupanje na snagu</b></p> <p>Ova Administrativna uredba stupa na snagu na dan njenog potpisivanja od strane Ministra.</p> <p style="text-align: center;">_____ <b>Prof.dr.Ramë Buja ministar</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24 Entry into force</b></p> <p>This Administrative instruction enters into force with its signature by Minister.</p> <p style="text-align: center;">_____ <b>Prof. dr. Ramë Buja, minister</b></p>